

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 14 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

“Drejtësia jo vetëm duhet të vihet në vend, por është po aq e rëndësishme të vihet re kur ajo bëhet”, do të arsyetonte një gjyqtar anglez në fillim të shekullit të kaluar. Sot është e rëndësishme vendosja në vendin e duhur kushtetues të së drejtës së pakicës parlamentare për të ngritur komisionin e hetimit, për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Po aq i rëndësishëm është edhe manifestimi i këtij pushteti që zotëron pakica në parlamentarizmin shqiptar. Sot ne, shumica parlamentare socialiste, do të ushtrojmë tërësisht vullnetin politik për ta zbatuar këtë të drejtë kushtetuese të pakicës parlamentare, për të hetuar zgjedhjet e 25 prillit, me vetëdije të thellë kushtetuese dhe përgjegjësi të lartë morale dhe qytetare. Ne jemi të bindur, si nga leximi i thjeshtë i tekstit të Kushtetutës, ashtu edhe nga rrugëtimi ynë i vështirë politik, ku na është mohuar kjo e drejtë për vite të tëra, se hetimi parlamentar është e drejtë e pamohueshme për të fuqizuar pakicën parlamentare të bëjë detyrën e saj kushtetuese dhe ligjore.

Ndaj sot, jo me fjalë, por me vota do të vendosim t’ju fuqizojmë të hetoni procesin zgjedhor të 25 prillit, të hetojmë së bashku çdo pretendim tuajin, pasi jemi të bindur se vetëm përmes ushtrimit të kontrollit kushtetues ne mund të përmirësojmë kuadrin ligjor, si dhe të forcojmë kapacitetin institucional të sistemit tonë zgjedhor. Ne jemi të gatshëm t’i futemi së bashku punës e të hetojmë sesi shteti ka garantuar të drejtën e qytetarëve për zgjedhje të lira e të fshehta, siç dëgjuam, që u citua nga raporti i OSBE-së, por jo për të dubluar institucionet që e kanë detyrë funksionale apo për t’u mbivendosur me pushtete të tjera. “Vetëm duke qëndruar brenda kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që kryhen si përfaqësues të popullit për sqarim, apo hulumtim të hollësishëm, mund të realizohet e drejta juaj e hetimit.”, interpreton Gjykata Kushtetuese në nenin 77, në vendimin e saj nr. 18 të vitit 2003. Jemi të bindur se kontrolli parlamentar dhe transparencja e mbrojnë pacenueshmërinë dhe integritetin e zgjedhjeve. Ndaj sot, me seriozitetin më të madh, ndërmarrim detyrimin e përbashkët përpara zgjedhësve për të verifikuar, nëse të dhënat personale të votuesve, nëse fondet publike, nëse legalizimet e ndërtimeve informale apo nëse punësimet në administratën publike janë përdorur për qëllime elektorale. Vetëm analiza nga ky komision i çdo akti që rregullon lëndën, duhet të shërbejë për të hedhur dritë jo mbi këndvështrime partiake, por vetëm mbi të vërtetën. Ky është detyrimi ynë kushtetues dhe ligjor ndaj zgjedhësve shqiptarë. Së bashku duam ta bëjmë Shqipërinë anëtare të Bashkimit Europian, ndaj dhe kemi zgjedhur që përmes ushtrimit të kontrollit të përbashkët parlamentar të përmirësojmë më tej zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri. Ju takon juve tashmë të tregoni përmes ushtrimit të detyrës kushtetuese dhe ligjore se qëllimi juaj i vetëm është përputhja e plotë e zgjedhjeve tona të lira dhe demokratike me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare. Vendi ka nevojë për bashkëpunim serioz mes nesh. Ne sot kryem detyrën tonë si shumicë duke i hapur rrugën hetimit të shqetësimeve tuaja, pasi besojmë që Shqipëria nuk meriton të shkojë pas, në një rrugë që ju e njihni më mirë.

Ndërkohë, le të vazhdojmë të bashkëpunojmë brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore në mënyrë që t’u forcojmë zgjedhësve besimin te procesi zgjedhor dhe institucionet që dalin prej tij. Faleminderit!